



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-23-0205

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

R M, nga Kaçaniku, i përfaqësuar nga avokati D R nga Kaçaniku.

Kundër:

E paditura/Ankuesja

NSH "Mladost" në Shtërpc e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP)**, Rruga, "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami, dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, SCC-09-0124, të datës 31 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 28 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesat refuzohen si të pa bazuara.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, SCC-09-0124, i datës 31 mars 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 8 korrik 2009, paditësit S M,L M,E M,A M,N M,T M,B M,R MB M,L M,N M,, nga Kaçaniku, të përfaqësuar nga avokati D R nga Kaçaniku parashtruan padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Privatizimin (DHPGJS), me të cilën kërkuan të njihen se janë pronarë të këtyre pronave të paluajtshme:

- n.k. nr..., vendin e quajtur "....." livadh, kl.5, sipërfaqja: 00.57,96 ha;
- n.k. nr..., vendin e quajtur "... " fushë, kl.5, sipërfaqja: 00.20,54 ha;
- n.k. nr..., vendin e quajtur "...." livadh, kl.5, sipërfaqja: 00.15,6 ha;
- n.k. nr..., vendin e quajtur "...." kullosë, kl.3, sipërfaqja: 00.28,78 ha;
- n.k. nr..., vendin e quajtur "....." livadh, kl.5, sipërfaqja: 00.73,31 ha;
- n.k. knr..., vendin e quajtur "....." mal, kl.2, sipërfaqja: 02.07,66 ha;
- n.k. nr..., vendin e quajtur "...." livadh, kl.5, sipërfaqja: 00.09,89 ha;
- n.k. nr..., vendin e quajtur "... " kullosë, kl.3, sipërfaqja: 00.19,67 ha;
- n.k. nr..., vendin e quajtur "... " fushë, kl.5, sipërfaqja: 00.50,79 ha;

Të gjitha këto identifikohen në fletën poseduese nr...., në Kadastrën Komunale në S, dhe

- n.k. nr..., vendin e quajtur "... " livadh, kl.5, sipërfaqja: 00.13,82 ha;
- n.k. nr..., vendin e quajtur "....." fushë, kl.6, sipërfaqja: 01.59,16 ha;
- n.k. nr,,, vendin e quajtur "....." livadh, kl.5, sipërfaqja: 00.09,17 ha;

Të identifikuar në fletën poseduese nr..., komuna kadastrale S. (sipas operatorit komunal i cili ka qenë në fuqi pas incizimit ajror gjatë vitit 1958).

Paditësit në padi pohojnë se paraardhësi i tyre D R M, tani i ndjerët, ka qenë pronarë i pasurisë së paluajtshme, dhe tani është e regjistruar në emër të së paditurës.

Më 25 tetor 2011, paditësit parashtruan propozim për masë të përkohshme sepse, sipas paditësve AKP-ja në valën nr. 53 ka shpallur privatizimin e aseteve të Ndërmarrjes së Re "Toka Bujqësore" në S, Komuna e Kaçanikut, e cila e ka sipërfaqen prej 26.7 ha. Nga kjo sipërfaqeje e përgjithshme, paditësit pohojnë se ata duhet ta kenë të drejtën e pronësisë në pjesën e pronës së paluajtshme në sipërfaqe prej 05.92,38 ha.

III

Në një parashtrësë të mëvonshme të datës 14 nëntor 2011, paditësit pohuan se Agjencia e Privatizimit (AKP) e ka caktuar shitjen e pronës së kontestuar për datën 16 nëntor 2011, se AKP-ja do ta shiste tokën me çmim shumë të ulët dhe se paditësit, edhe nëse më vonë do ta fitonin rastin, kurrë nuk do të merrnin kompensimin e duhur. Ata do të ishin vetëm kreditor në procedurën e likuidimit, dhe do të merrnin vetëm një pjesë të vogël të vlerës. Paditësit kësaj parashtrëse ia bashkëngjiten aktvendimin e trashëgimisë të Gjykatës Komunale të Kaçanikut të datës 3.9.2009 në gjuhën shqipe, me njoftimin se më vonë ata do ta dorëzonin përkthimin.

Aktvendimi i trashëgimisë vërteton se R M është i vetmi trashëgimtar i të ndjerit.

Me 15 nëntor 2011, Trupi gjykues i DHPGJS-së, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për caktimin e masës së sigurisë.

Me 13 dhjetor 2011 paditësit kane parashtruar ankesë, kundër Aktvendimit të Trupit gjykues të DHPGJS, SCC-09-0124 të datës 15 nëntor 2011, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkohen nga Kolegji i Apelit, që të ndryshohet Aktvendimi i ankimuar, dhe të caktohet masa e sigurisë.

Me 16 janar 2012, në përgjigjen në urdhrin e datës 15 nëntor 2011, paditësi ka bërë plotësimin dhe precizimin e padisë, duke parashtruar aktvendimin e trashëgimisë Tnr.16/09 të datës 16.03.2009 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Kaçanik për trashëgimin e të ndjerit D M ish nga Kaçaniku. Në bazë të këtij aktvendimi si trashëgimtar i vetëm është shpallur R M i biri i të ndjerit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit precizon padinë në aspektin subjektiv, duke e cekur se cilësia e paditësit ti njihet R M si trashëgimtar i vetëm i D M ish nga Kaçaniku.

Paditësi ka paraqitur si dëshmi:

IV

Aktvendimin e trashëgimisë T.nr... te datës të lëshuar nga Gjykata Komunale ne Kaçanik për trashëgimin e te ndjerit D M ish nga Kaçaniku, Kopjen e kontratës së datës ... të lidhur në mes të Kooperativës Bujqësore KB "R A", KB Kosova Eksporti dhe Komunës së Kaçanikut, Kopjen e vendimit të Këshillit Popullor të Komunës së Kaçanikut nr. 1045, me datë 25.04.1962,

Kopjen e vendimit të lëshuar nga Komuna e Kaçanikut, me datë 11.11.1963.

Kopjen e procesverbalit lëshuar nga Komisioni me datë 28.08.1970,

Kopjen e vendimit të revizionit me nr.1886/67 të datës 15.10.1971,

Një flete poseduese të datës, lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi në Kaçanik (në fuqi deri në fund të vitit..) që prona kontestuese ka qenë emër të D R M.

Kopjen e planit për pronën kontestuese të datës 5.12.2011,

Kopjen e Vendimit 01 nr173/02 te datës 05.06.2002 të lëshuar nga Komuna e Kaçanikut .

Kopjen e Vendimit nr. 35-/04 te datës 12.02.2004, vendim mbi abrogimin e aktvendimeve dhe marrjen nga shfrytëzimi te tokës bujqësore të marr nga Komuna e Kaçanikut.

Me 16 janar 2013, Kolegji i Apelit e ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar, e ka prish Aktvendimin e Trupit gjykues të DHPGJS-së, SCC-09-0124 të datës 15 nëntor 2011, dhe ka vendos masën e përkohshme, duke ndaluar AKP-në që të tjetërsoj ngastrat kontestuese.

Me 29 dhjetor 2014, AKP-ja paraqiti mbrojtjen në padi. Në mbrojtjen në padi AKP-ja e ka kundërshtuar pretendimet e paditësit të paraqitura në padi, duke i konsideruara si të pabazuar në ligj. AKP-ja pohon se paditësi nuk e mbështet pretendimin e tij me prova të duhura, padia është në kundërshtim me nenin 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit mbi DHPGJS-në, dhe nenit 253 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Në lidhje me pretendimet se pasuria është transferuar në pronë publike pa baza ligjore, ata e citojnë nenin 268 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, i cili parashikon që kthimi i saj mund të kërkohet brenda afatit 5 vjeçar, duke filluar nga dita e njoftimit dhe më së voni brenda afatit 10 vjeçar. Prandaj, mbi këtë bazë

është parashkruar kërkesa për kthimin eventual të pasurisë së paluajtshme përmes procedurës gjyqësore. AKP në mbrojtje në padi konsideron se Kooperativa Shtërpce ("Mladost"), është pronare legjitime e pronës së kërkuar nga paditësi prandaj, i propozon Gjykatës që të refuzojë padinë e paditësit si të pabazuar.

Me 18 nëntor 2021, Kolegji i shkallës së I-rë i DHPGJS-së e mbajti një seancë dëgjimore, në të cilën përfaqësuesi i paditësit mbeti pranë padisë dhe parashtresave të dorëzuara gjykatës, dhe propozoi caktimin e ekspertit të gjeodezisë, për të paraqitur gjendjen e tanishme faktike, por edhe më të hershme të pronës kontestuese, sepse ai pohon se ka mos përputhje të ngastrave kadastrale, e posaçërisht ku një pjesë e kësaj paluajtshmërie, është shitur nga AKP-ja.

Përfaqësuesi i AKP-se edhe në seancë mbeti në tërësi pranë mbrojtjes së paraqitur në padi, duke konsideruar se padia e paditësit është tërësisht e pabazuar. AKP-ja theksoi se NSH „Mladost“, qysh nga viti 1965, është bërë pronare e ngastrave kontestuese, duke cekur se një pjesë e këtyre ngastrave në valën e 53 të privatizimit në vitin 2011 janë shitur, por pas pranimin të Aktvendimit të Kolegjit të Apelit, ASC-11-0109, ka ndaluar shitjen e ngastrave tjera të mbetura në emër të NSH 'Mladost'. Tutje AKP-ja në këtë seancë nuk e kundërshtoi propozimin e paditësit për caktimin e ekspertit të gjeodezisë, edhe ajo ishte e mendimit që eksperti do të pasqyroste me së miri gjendjen dhe ecurinë e regjistrimit të këtyre ngastrave kontestuese. Gjykata në këtë séance e aprovoi kërkesën e palëve për caktimin e ekspertit të gjeodezisë.

Gjykata caktoi Ekspertin e licencuar të gjeodezisë z.F I, duke kërkuar nga ia që të bënë në mënyrë të kjart, identifikimin e kësaj paluajtshmerie, të vlerësoj se kush e posedon aktualisht pronën kontestuese, gjendjen e tanishme faktike, por edhe me të hershme, të nxjerr historiatin e të gjitha ndryshimeve, dhe vërtetimin e gjendjes faktike të gjitha parcelave me sipërfaqe që ato kanë pasur në kohën e marrjes së këtyre parcelave, nga paraardhësi- i ndjeri D M e deri në ditën e sotme .

Eksperti ka dorëzuar në gjykatë Ekspertizën duke vepruar në përputhje me kërkesat e gjykatës dhe ka paraqitur gjendjen faktike të ngastrave kontestuese, ka paraqitur edhe historiatin e ngastrave kontestuese, certifikatën e pronësisë për ngastrat të cilat janë në emër të paditurës të datës 28.06.2022.

Gjykata përmes urdhrit për caktimin e seancës dëgjimore i ka dorëzuar palëve nga një kopje të Ekspertizës gjeodezike .

Me 25 tetor 2022, Kolegji i shkallës së I-rë e mbajti edhe një seancë dëgjimore ku pala paditëse parashtroi në formë të shkruar vërejtjet e tij, në ekspertizën gjeodezike duke kërkuar plotësimin e saj.

Gjykata dërgoi parashtresën e paditësit ekspertit për plotësim dhe përgjigje në vërejtjet e bëra nga përfaqësuesi i paditësit.

Me 01 dhjetor 2022, Eksperti parashtroi plotësimin e ekspertizës. Ky plotësim i ekspertizës u dërgua palëve .

Me 15 dhjetor 2022, paditësi në bazë të këtij plotësimi të ekspertizës parashtroi një parashtresë dhe bëri precizimin e kërkesëpadisë.

Me 21 shkurt 2023, në seancën e fundit paditësi parashtroi fjalën përfundimtare me shkrim në të cilën ri theksoi se në baze te provave dhe dëshmime të administruara, u dëshmuua se prona kontestuese deri në vitin 1964 ka qenë në emër të paraardhësit të paditësit, përkunder që me Aktvendimin e Këshillit Popullor të Kacanikut nr.1045 te dates 25.04.1962 i ndjeri D M ishte shpallur uzurpues i pronës shoqërore. Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka ushtruar Revizion. Ai pohon se këto prona deri sa çështja ka qenë në procedurë të revizionit, Komuna e Kacanikut, dhe KB "R A" dhe KBI Kosmet Export",kanë nënshkruar Kontraten mbi bartjen e të drejtës se shfrytëzimit të pasurisë bujqësore, në baze te vendimit të datës 19.10.1962. Komisioni për shqyrtimin e Marrdhënieve Pronësore juridike ka marr Aktvendim me

VII

nr.1886/67 të datës 15.10.1971 me të cilin ka aprovuar Revizionin duke anuluar Aktvendimin nr.1045 te datës 25.04.1962 si te pa bazuar, me çka është fituar baza juridike që këto ngastra ti dorëzohen në posedim dhe shfrytezim paraardhësit të paditesit. Tutje ii thekson se me aktvendimin nr.1886/67 te dates 15.01.1971, është dashur që me automatizëm të anulohen të gjitha vendimet komunale që jane marr lidhur me transferimin e këtyre pronave të Kooperativat Bujqësore. Në vitin 1992 e gjithë pasuria e KBI ka kalur ne emër të KB Zadruga Shtërpce, e në historiat të këtyre ngastrave nuk ka asnje provë se në çfarë bazë janë bartur në emër të Kooperativës Shtërpce. Paditësi pohon se Paraardhësi i tij është shpronësuar pa bazë juridike, dhe akti juridik me të cilin në fillim është shpallur uzurpues ka humbur vlerën juridike, ndërsa evidentimi në emer te Koopertives Shtërpce është pa bazë juridike. Andaj nga gjykata kërkon që të aprovohet precizimi i kërkesë padisë dhe ti njihet e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale:

- nr., vendi i quajtur "" livadh, kl.5, sipërfaqja 00.57,96 ha;
- nr..., vendi i quajtur "" arë, kl.5, sipërfaqja 00.20,54 ha;
- nr..., vendi i quajtur " ..." livadh, kl.5, sipërfaqja 00.15,63 ha;
- nr..., vendi i quajtur ." "" kullosë, kl.3, sipërfaqja 00.20,78 ha;
- nr..., vendi i quajtur "... " livadh, kl.5, sipërfaqja 00.07,31 ha;
- nr..., vendi i quajtur "... " mal, kl.2, sipërfaqja 02.07,66 ha;
- nr..., vendi i quajtur "... " livadh, kl.5, sipërfaqja 00.09,89 ha;
- nr..., vendi i quajtur "... " kullosë, kl.3, sipërfaqja: 00.19,67 ha;
- nr..., vendi i quajtur "... " arë, kl.5, sipërfaqja: 00.50,79 ha. Të gjitha këto në Zonën Kadastrale S Komuna e Kaçanikut.

Përfaqësuesi i AKP-së edhe në seancën e fundit mbeti pranë të gjitha kundërshtimeve te paraqitura ne mbrojtje, kundërpërgjigje dhe deklarimeve te seancave te kaluara, dorëzoi një deklaratë me shkrim ku e kundërshton precizimin e padisë, duke theksuar se paditësi edhe pse ka qenë në dijeni nga historiat por edhe nga ekspertiza gjeodezike, se shumica e parcelave të pretenduara evidentohen në emër te palës së tretë privatizuesit E H, ndërsa disa parcela evidentohen ne emër te Qeverise se Kosovës, paditësi nuk ka

VIII

precizuar padinë në kuptim të legjitimitetit, ngase të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv për shumicën e ngastrave, ngase ato tashmë janë privatizuar. AKP-ja pohon se paditësi edhe pse ka qene në dijeni që prona është privatizuar, ai nuk ka vepruar në bazë të nenit 17 par.5 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034, apo nenit 10 par.3.2 të Ligjit te Dhomës së posaçme, por insiston ne vërtetimin e pronësisë. AKP-ja propozoi qe padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Me datë 31 mars 2023, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS me pikën **I** të dispozitivit të Aktgjykimit, SCC-09-0124 e refuzon si të pa bazuar padinë e paditësit, lidhur me ngastrat kadastrale nr..., nr., nr., nr., nr. ..dhe nr..., ndërsa me **II** të dispozitivit të Aktgjykimit, e aprovon si të bazuar padinë e paditësit, për ngastrat kadastrale nr..., nr..., nr..., nr. ..dhe nr.... Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS ka arsyetuar pas administrimit të gjitha provave të paraqitura nga palët, deklarimeve të tyre në seancat e mbajtura, duke marrë parasysh ekspertizën gjeodezike, dhe plotësimin e saj, si dhe fjalën përfundimtare konkludon se padia, lidhur me ngastrat., .., .., , ..dhe., është e bazuar. Tutje Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se nga ekspertiza e paraqitur nga eksperti i gjeodezisë, plotësimi i saj, dhe vet historiku kadastral i Drejtorisë për Gjeodezi e Kadastër, në mënyrë të qartë është paraqitur gjendja e këtyre ngastrave kadastrale. Ngastrat kadastrale, nr. ,,dhe ..qysh ne vitin., kanë pësuar ndryshime. Ngastra ..është ndarë në dy pjesë, tani është ..dhe... Po ashtu edhe ngastra, ..është ndare në dy pjesë nën ..dhe... Ngastrat dhe .. janë privatizuar nga AKP-ja në valën e 53 të privatizimit me datë 28 mars 2012. Në vitin 2013, këto ngastra janë bashkuar, dhe është krijuar ngastra me nr.... ZK S. Në vitin 2021, ngastra ...ndahet në 6 pjesë për shkak te ndërtimit të autostradës ku katër pjese të saj, ngastra nr..., .., .., dhe., mbesin në emër të blerësit E H, ndërsa ngastrat nr. ...dhe..., janë në emër të Qeverise se Kosovës. Ngastrat e larte cekura janë në kuadër të ngastrës..., që janë në emër të E H, dmth në emër të personit të tretë. Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se të paditurës për këto ngastra i mungon *legjitimiteti i saj real- pasiv* (neni 73 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, ligji nr. 03/L-006 -LPK). Paditësi edhe pse ishte në dijeni për gjendjen e këtyre ngastrave nga ekspertiza dhe plotësimi i ekspertizës, edhe në precizim të kërkes padisë, ai ende kërkon ngastrat

të cilat nuk janë në posedim, shfrytëzim dhe në pronësi të paditurës KB "Mladost", nga se qysh nga viti 2012 janë privatizuar respektivisht eksproprijuar. Andaj, Kolegji i shkallës së I-rë konsideron se e paditura nuk mund të obligohet që të jap një të drejtë paditësit. Kjo rrjedh nga parimi se askush nuk mund të bartë tek tjetri më shumë të drejta përveç se ato të drejta që i ka apo i disponon ("*Nemo plus iuris ad alium transferre potest quam ipse habet*"). Tutje Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se paditësi nuk ka kërkuar kompensimin në vend të kthimit fizik, siç parasheh neni 10 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, në këtë aspekt kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Tutje Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se padia lidhur me ngastrat kadastrale, .., ... dhe.., të cilat aktualisht janë në emër të KB Shtërpce, është e bazuar. Nga Aktvendimi i Revizionit nr.1886/67 të datës 15.10.1971, fillimisht me pikën 1 (një), është prishur Vendimi nr. 1045 datë 25 prill 1962, me të cilin procedura për uzurpim është pezulluar, me pikën 2 (dy), të dispozitivit është hudhur fletëparaqitja ndaj paaradhësit të paditësit, D R M, si uzurpator i pronës kontestuese (*'samovlasno zauzece*). Nga arsyetimi i Vendimi i Revizionit, shihet se, asnjëherë nuk është dëshmuar se prona kontestuese ishte e bartur në fondin e pronave shoqërore. Për më tepër thuhet se prona fillimisht gjatë viteve 1928 i është marr nga pronarët paraprak dhe ju janë ndarë kolonistëve, gjatë periudhës së Mbretërisë. Tutje, pas viteve të pasluftës, viteve 1946, prona kontestuese përfshirë edhe pronat tjera ju janë kthyer ish pronarëve, por kjo e drejtë nuk është finalizuar me një vendim të organeve kompetente. Në vijim, nga dokumentet e parashtruara kopjes se fletës poseduese të datës ..., te lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi në Kaçanik (në fuqi deri në fund të vitit 1965), prona kontestuese ka qenë emër të D R M . Kthimi i tokës me vendim të autoriteteve publike në vitin 1971 ka rezultuar në kthimin e menjëhershëm të pronës së pronarit të mëparshëm, por kjo nuk ka ndodhur ngase prona ka mbet e regjistruar si pronë shoqërore. Kolegji i shkallës së I-rë konstaton se Vendimi i Revizionit ka vlerën e titullit ekzekutiv pronësor, andaj kolegji vendosi që paditësit ti njihet e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale me nr....., dhe ... ZK S, ndërsa obligohet e paditura që t'ia njoh dhe të lejoj regjistrimin e paditësit si pronar i ngastrave

të paraqitura në pikën 2 të dispozitivit, pasi që këto ngastra edhe tani janë të regjistruara në emër të NSH "Mladost" Shtërpce.

Me datë 07 prill 2023, AKP-ja përmes postës e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër pikës **II** të dispozitivit të Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, SCC-09-0124 të datës 31 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet pika e II e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim, ose të ndryshohet pjesa e goditur e Aktgjykimit të ankimuar, dhe të refuzohet në tërësi padia si e pa bazuar. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se pjesa e goditur e Aktgjykimit të ankimuar ka dispozitiv të pa kuptueshëm, dhe nuk është në përputhje me arsyetimin si dhe nuk përmban arsye për faktet vendimtare. Tutje AKP-ja konsideron se me Aktgjykimin e ankimuar janë shkelur rëndë dispozitat e procedurës kontestimore. AKP-ja në ankesë konsideron se Gjykata e Shkallës së I-rë nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, pasi që në bazë të kontratës Ov.br. ...të datës .. mars., palujtshmëria lëndore ka kaluar në emër të paditurës. Në rastin konkret paditësi nuk e ka kundërshtar kontraten për bartjen e palujtshmërisë, andaj për këto arsye gjykata nuk ka mundur që ti ja njeh të drejtën e pronësis paditësit duke ditur që egziston kontrata e shitëblerjes. AKP-ja pohon se si rjedhoj e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Shkallës së I-rë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale.

Me datë 14 prill 2023, përmes postës paditësi e ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër pikës **I** të dispozitivit të Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë SCC-09-124 të datës 31 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet pika I e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, dhe të aprovohet padia si bazuar edhe për ngastrat nr...,..., dhe nr..... Për më tepër në ankesë paditësi pa pohuar se me pjesën e goditur të Aktgjykimit të ankimuar janë shkelur dispozitat kontestimore, pasi që ka kundërthënje për faktet vendimtare e gjithashtu edhe arsyet e Aktgjykimit nuk qëndrojnë lidhur me faktet të cilat janë marr për bazë. Paditësi konsideron se pjesa e goditur e Aktgjykimit ka shkelur nenin

182 par.2 pika n) të LPK-së. Padiësi në ankesë konsideron se Gjykata e Shkallës së I-rë nuk e ka shqyrtar drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjitha provat, duke nxjerr konstatime të gabuara lidhur me gjendjen faktike. Padiësi poashtu konsideron se gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale. Tutje padiësi pohon se konstatimet e dhëna nga Shkalla I-rë, janë të gabuara kur gjykata ka konstatuar se ngastrat lëndore nuk janë në pronësi, nuk janë në shfrytëzim dhe nuk janë në posedim tek e paditura, andaj e paditura nuk ka mund të obligohet që padiësit t'ia njeh të drejtën e pronësisë edhe për këto ngastra. Padiësi konsideron se një konstatim i till ligjerisht është i pa qëndrueshëm, ngase ka qenë në fuqi masa e përkohshme e vendosur me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit ASC-11-0109-A001 të datës 16 janar 2018, por e paditura duke mos respektuar këtë Aktvendim ka publikuar tenderin për shitje, dhe në valën e 53 të shitjes, përveq tjerash ka shitur ngastrat nr., nr.,,,,,,, përsonit të tretë. Tutje padiësi pohon se me padi ka kërkuar njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrat lëndore të padisë, e nuk ka kërkuar kompensim për këto ngastra pasi që paraprakisht duhet të egzistoj baza juridike- njohja e drejtës së pronësisë. Gjykata është dashtë të vërtetoj se paraardhësi është shpronsuar pa bazë ligjore nga pronat të cilat i kërkon me padi, ashtu që ky Aktgjykim do të ishte titull juridik pronosor në bazë të cilit do të krijohet baza juridike që të kërkohej kompensimi në bazë të dispozitave të LMD-së, por edhe në bazë nenit 10 par 3 të LDHP-së. Padiësi në ankesë pohon se në këtë fazë nuk ka pasur titull juridik gjyqësor, për të kërkuar kompensim financiar. Në ankesë padiësi i është referuar edhe një rasti nga jurospodencia e Kolegjit të Apelit AC-I-15-0249 të datës 10 qërshor 2016.

Me datë 08 qërshor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen në ankesën e padiësit. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të padiësit, dhe e mbështet pjesën e kundërshtuar nga padiësi të Aktgjykimit, duke konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. AKP-ja pohon se padiësi nuk ka arritur të paraqes ndonjë bazë juridike të besueshme, dhe nuk ka mund të konstatoj gjendjen tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar me Aktgjykimin e ankimuar. Tutje AKP-ja konsideron se ankesa e padiësit nuk përmban asnjë dëshmi, fakt apo provë relevante në mbështetje të pretendimeve të tilla. Tutje

XII

AKP-ja pohon së është i pa qëndrueshem pohimi i paditësit se AKP-ja nuk e ka rrespektuar Aktvendimin e Kolegjit të Apelit ASC-11-0109-A0001 të datës 16 janar 2018. AKP-ja pohon se kontrata e shitjes përmes privatizimit me tender ishte lidhur me 28 mars 2012, pra shumë kohë para se të lëshohej masa e sigursë nga Kolegji i Apelit i DHPGJS. Ky fakt vërtetohet edhe nga historiat për pronat që janë objekt i këtij kontesti i hartuar nga Komuna e Kaçanikut me datë 27 qershor 2022. Tutje AKP-ja pohon se paditësi në vend që të kërkoj zgjidhje brenda kornizave ligjore, zgjedh që të paraqesë situata të pa qena, gjoja AKP-ja ka privatizuar parcela edhe pse kishte vendim për masë të sigurisë, gjë që kjo nuk qëndron. AKP-ja pohon se paditësi nuk ka mundësi në bazë të nenit 73 të LPK-së të kërkoj të drejtën e pronësis për patundshmëri të cilat nuk evidentohen në emër të paditurës, por të cilat janë në pronësi të palës së tretë. Në rastin konkret kërkesë padia ka qenë edhe pa objekt me që egziston kontrata e shitëblerjes për parcelat lëndore P.nr.. të datës..., dhe se paditësi edhe pse ishte në dijeni për këtë fakt nuk kishte kërkuar anulimin e kësaj kontrate.

Me datë 31 maj 2023, në bazë fletëdorëzimit që egziston në dosje, avokati i paditësit e ka pranuar ankesën e AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Me datë 07 mars 2024, Kolegji i Apelit e lëshoi një Urdhër për paditësin, me të cilin është kërkuar që ai të dërgon në gjykatë Aktvendimin e noterizuar të Komisionit për rishqyrtimin e marrëdhënieve pasurore të kryera me uzurpim të tokës në pronësi shoqërore të Komunës së Kaçanikut, nr.04-1886/67 të datës 15 tetor 1971.

Me datë 13 mars 2024, paditësi e dorëzoi në DHPGJS në parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit, me të cilën parashtresë ai ka dërguar Aktvendimin e noterizuar të Komisionit për rishqyrtimin e marrëdhënieve pasurore të kryera me uzurpim të tokës në pronësi shoqërore të Komunës së Kaçanikut, nr... ,...të datës .. tetor....

Arsyetimi ligjor

Ankesat e paditësit dhe e të paditurës refuzohen si e pa bazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësit, pretendimet ankimore të AKP-së, dhe të gjitha provat të cilat janë nxjerr nga Kolegji i Shkallës së I-rë, dhe konstaton se të dy ankesat janë të pa bazuara.

Kolegji i Apelit i mbështet të gjeturat faktike dhe konstatimet që i ka dhënë Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së lidhur me objektin e kontestit, pasi ato janë të sakta dhe të mbështetura në prova.

AKP-ja me ankesën e saj e ka kundërshtar pikën e **II-të** të dispozitivit të Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë, në bazë të cilit paditësit i është njohur e drejta e pronësisë për ngastrat nr. dhe nr.....

Kolegji Apelit konstaton se është i drejtë konstatimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë se paditësi lidhur me këto ngastra e ka një titull të vlefshëm pronësor, Aktvendimin e revizionit nr. 1886/67 të datës 15.10 1971, me të cilin Aktvendim ishte prishur vendimi nr. 1045 i datës 25 prill 1962, dhe ishte ishte hedhë poshtë fletëparaqitja për uzurpim të ngastrave lëndore.

XIV

Andaj bazuar në këtë dokument, dhe në faktin se deri në fund të vitit 1965 këto prona kanë qenë në emër të paraardhësit D R M, atëherë pa ndonjë bazë ligjore këto ngastra janë evidentuar si pronë shoqërore në emër të NSH-së së paditur.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja me ankesë e saj në shkallën e dytë i referohet një kontrate OV.br. ... të datës .. mars, sipas së cilës kontratë, sipas AKP-së pronat lëndore kanë kaluar në emër të paditurës. Kjo kontratë me këtë numër nuk ekziston në dosje të lëndës të shkallës së I-rë.

Në bazë të procesverbalit të seancës dëgjimore të mbajtur me 18 nëntor 2021, përfaqësuesi i AKP-së nuk e përmend këtë kontratë. Kjo kontratë nuk përmendet nga përfaqësuesja e AKP-së, as në seancën e fundit dëgjimore të mbajtur me datë 21 shkurt 2023, ku palët në këtë seancë kanë paraqitur fjalën përfundimtare. Me ankesën në shkallën e dytë AKP-ja nuk e bashkëngjit këtë kontratë. Kjo kontratë nuk ka qenë as objekt i kërkesë padisë.

Prandaj Shkalla e I-rë në Aktgjykimin e ankimuar nuk ka dhënë asnjë vlerësim për këtë provë, rrjedhimisht as Kolegji i Apelit nuk do të marr ndonjë qëndrim ligjor për këtë provë, në bazë së cilës AKP-ja konsideron se është dashtë të refuzohet në tërësi kërkesë padia e paditësit si e pa bazuar.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konsideron se bazuar në provat e administruara nga Kolegji i shkallës së I-rë, në ekspertizën gjeodezike, në plotësim ekspertizën gjeodezike, në historiatin e ngatrave, dhe në fletën poseduese të datës 22.11.2011 të lëshuar nga Drejtoria për gjeodezi KK Kaqanik, shkalla e I-rë e DHPGJ-së me të drejtë paditësit ia ka njohur të drejtën e pronësisë paditësit për ngastrat nr....., dhe nr..., me që ai e ka një titull të vlefshëm pronësor.

Paditësi me ankesën e tij të datës 14 prill 2023, e kundërshton pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë, lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, dhe atë për ngastrat nr., dhe nr.....

Kolegji i Apelit konsideron se Kolegji i Shkallës së I-rë drejt ka vepruar kur në bazë të nenit 73 të LPK-së, këtë pjesë të kërkesë padisë për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv, e ka refuzuar kërkesë padinë si të pa bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se në bazë të provave që ekziston në dosje, ngastrat lëndore të përfshira në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, tashmë janë shitur nga ana e AKP-së prej personave të tretë, dhe këtë fakte e dinë edhe paditësi. Tutje disa prona të shitura personit të tretë, janë shpronësuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për nevojat dhe interesat publikë, andaj është e qartë që këto prona të shitura në kohën e gjykimit të padisë nuk janë më në emër të NSH-së së paditur.

Kolegji i shkallës së I-rë është i lidhur me kërkesë padinë. Gjykata nuk ka autorizime ligjore të vendosë jashtë kërkesë të padisë. Paditësi kishte njohuri për faktet që këto prona të përfshira në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit, janë shitur nga AKP-ja dhe janë në emër të personit të tretë, apo edhe disa janë shpronësuar nga Qeveri e Kosovës. Siç ka konstatuar saktë shkalla e I-rë, paditësi nuk ka paraqitur kërkesë për kompensim eventual monetar për këto ngastra të shitura.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konsideron se me të drejtë Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së e kishte refuzuar pjesërisht kërkesë padinë lidhur me ngastrat lëndore të pikës I të dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë.

Andaj duke u bazuar në këto arsye, Kolegji i Apelit konsideron se rezultati i dhënë në Aktgjykimin e ankimuar nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj të dy ankesat ajo e AKP-së, dhe paditësit refuzohen si të pa bazuara, ndërsa vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJ-së, si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

AKP-ja dhe Paditësi tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 24 maj 2023, dhe 06 qershor 2023, në shumë prej nga 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 28 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
